# DËSHMI ARKIVI

**A-464989**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Takimi i Bordit të Paqes në Nju Jork - Ministri Hoxha: Shqipëria kontribut aktiv në përputhje me planin 20-pikësh të Presidentit Trump |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/takimi-i-bordit-te-paqes-ne-nju-jork-ministri-hoxha-shqiperia-kontribut-i588054` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 08:17:50 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 09:10:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3451c628e056f6faba2474d8251a6383c3fce5397cb4380bf4b6f08ebac9a1c2` |
| TEKSTI | `e66ccd4acf8e4a33c86d3d0d4f1b03d76311c918d9bbd8570494d69ec2c21894` |
| PAMJA | `ef7c81e91246d8470fc215e5a194cb3b461afae7dee75d03b73b939cc62e7ee1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `04bd0095ad296b282b31da55ee724fdd5bc4c1a63fa918f9c99d8d724ec12780` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9a6b20a4f7bca7d38b85ed38d229f05609a1ca606edde02ba3c9e62d673a221c` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/04bd0095ad296b282b31da55ee724fdd5bc4c1a63fa918f9c99d8d724ec12780`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Takimi i Bordit të Paqes në Nju Jork - Ministri Hoxha: Shqipëria kontribut aktiv në përputhje me planin 20-pikësh të Presidentit Trump

TemA
24 Shtator 2026, 11:10Politika TEMA



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Ferit Hoxha mori pjesë takimin informues të Bordit të Paqes, së bashku me Komitetin Kombëtar për Administrimin e Gazës dhe Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë, të mbajtur në Nju Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Takimi u përqendrua në përpjekjet e vazhdueshme dhe të koordinuara për të adresuar një nga krizat ndërkombëtare më urgjente dhe komplekse të kohës sonë.

Ministri Hoxha nënvizoi se Shqipëria po i mbështet në mënyrë aktive këto përpjekje, përfshirë edhe përmes kontributit të saj në Forcën Ndërkombëtare të Stabilizimit (#ISF), në përputhje me Rezolutën 2803 (2025) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe planin 20-pikësh të Presidentit Trump.

"Ne mbetemi të përkushtuar për të punuar ngushtë me partnerët tanë për t'i përkthyer këto angazhime në përmirësime të prekshme në jetët e njerëzve të Gazës, duke ndihmuar në krijimin e kushteve për një të ardhme më të sigurt, të qëndrueshme dhe të begatë për të gjithë", tha Hoxha.

Angazhimet shumëplanëshe ndërkombëtare synojnë t'u përgjigjen nevojave të menjëhershme humanitare, duke hedhur themelet për siguri të qëndrueshme, stabilitet, rimëkëmbje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm në Gaza.

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Kuvendi mblidhet sot në seancë plenare, dy interpelanca urgjente dhe dy projektligje në rendin e ditës]

07:33 Politika

[“Të gjithë mbështetësit tanë të ngrihen në këmbë”/ Berisha përjashton opsionin e bojkotit të Parlamentit: Do të ishte avantazh për Ramën]

19:25 Politika / 27 komente

[Komisioni Europian: Negociatat me Shqipërinë për në BE drejt mbylljes në dhjetor 2027]

18:35 Politika / 20 komente

Kur James Bondi kthehet në Menekshe: Telendisja në telenovelë turke, e një spy story


18:05 Politika / 71 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.